



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 1 (827856)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 5 janar 2024

Presidenti Bajram Begaj: Ju lartësoni emrin e Shqipërisë, mishëroni vlerat tona!



Ministri Peleshi: Na bëni krenarë, jo vetëm në mbrojtje e siguri kombëtare, por edhe në eksportin e paqes e sigurisë kolektive

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral-major Arben Kingji, zhvilluan një bisedë online me efektivet shqiptarë, që kontribuojnë në misionet tona jashtë vendit.

Ministri i Mbrojtjes shprehu vlerësimet për këtë pjesë të Forcave të Armatosura që bën krenar të gjithë shqiptarët.

“Ju jeni pjesa më e ekspozuar në angazhimet tona ndërkombëtare. Na bëni krenarë, sepse i jepni një dimension tjetër angazhimit tonë, jo vetëm në mbrojtje e siguri kombëtare, por edhe në eksportin e paqes e sigurisë në mbrojtjen kolektive. Kjo na bën jo vetëm përfutës nga anëtarësia në këtë Aleancë të madhe, por edhe kontributorë, ndonëse Shqipëria është një vend i vogël, me kapacitete modeste, por gjithnjë në rritje dhe të modernizuara. Ndaj ne duam ta tregojmë veten dhe të japim kontributin tonë si në operacionet e NATO-s, Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian, Forcat Shumëkombëshe ushtarake, por edhe humanitare dhe Mbrojtjes Civile, siç kemi qenë vitin e fundit në mbështetje të vendeve të rajonit”, - u shpreh ministri Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes tha se Shqipëria përfaqësohet në 8 misione jashtë vendit: nga Iraku, Sudani i Jugut, Egjipti, Letonia, Bullgaria, Bosnja dhe Kosova, ku është edhe prezenca më e madhe në dy lokacione.

Z. Peleshi foli për konfliktet që janë shtuar sot në zona të ndryshme të globit, por edhe në rajon. Ndaj ai inkurajoi veçanërisht efektivet që



shërbejnë në misionin e KFOR-it në Kosovë, që të kontribuojnë me zell, por edhe me vetëpërmbytje, në mënyrë që të mos bien pre e provokimeve dhe situatave që mund të krijohen.

“Urojmë që konfliktet e ndezura të shkojnë drejt shuarjes. Duket se do të jetë një konflikt i gjatë në Ukrainë. Shpresojmë që të ketë një adresim sa më të shpejtë në krahun e së mirës, me fitoren e Ukrainës.

Urojmë që ky të jetë një vit i mbarë dhe i qetë për Kosovën dhe për rajonin e Ballkanin Perëndimor!”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Z. Peleshi foli edhe për planet dhe objektivat e mbrojtjes për vitin që vjen. “Pas pak javësh do të fillojë operacionet Baza Taktike Ajrore e Kuçovës, që është një bazë e NATO-s. Po punojmë që të fusim në planet e mbështetjes së NATO-s, me modelin e Kuçovës edhe ndërtimin e një porti pranë portit të ri në Porto Romano, një port ushtarak që do ta bënte vendin me dy infrastruktura të rëndësishme të NATO-s, për stërvitje, mbështetje taktike apo dislokime në rast nevojë, operacionesh drejt krahut lindor të NATO-s. Shqipëria është e vendosur të luajë rolin e saj në rajon, në krahun e Perëndimit. Ne kemi vetëm një agjendë dhe ajo është integrimi euroatlantik”, - theksoi ministri Peleshi. Nga ana e tij edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji shprehu vlerësimet maksimale për efektivet që shërbejnë në misionet paqeruajtëse jashtë vendit.

Dy helikopterë amerikanë “Black Hawk” i shtohen Forcave të Armatosura

Dy helikopterë amerikanë “Black Hawk” do t’i shtohen arsenalit të Forcave të Armatosura në fund të këtij muaji. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi bëri me dije se: “Ky është një investim i madh dhe një hap i rëndësishëm që do t’i japë Shqipërisë fuqinë dhe përkushtimin e nevojshëm, për të përmbushur misionet

taktike dhe operacionet e emergjencave me më shumë efikasitet dhe siguri”. Helikopterët amerikanë cilësohen si një lajm i shumëpritur në këtë fillim viti, në bashkëpunim me aleatin strategjik SHBA, si një shenjë e qartë se vendi ynë po bëhet një vend më i sigurt dhe i përgatitur për sfidat e ardhshme.





Presidenti Begaj: Ju lartësoni emrin e Shqipërisë, mishëroni vlerat tona!

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji dhe ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Petrit Malaj, me rastin e festave të fund-vitit vizitoi efektivet e Forcave të Armatosura të Shqipërisë që ndodhen në Komandën Rajonale Perëndim, “Camp Villagio Italia” të KFOR-it.

Presidenti Begaj shkëmbeu me ta urimet për vitin e ri 2024. Fillimisht, Presidenti u takua me komandantin e bazës ushtarake, kolonelin Gabriele Vacca. Në këtë takim Presidenti shprehu edhe një herë vlerësimin e tij për KFOR -in, si një histori sukcesi.

“Ajo që ju po bëni këtu është shumë e rëndësishme në mbrojtje të vlerave të lirisë dhe ruajtjes së paqes dhe sigurisë në rajon”, - i tha Presidenti komandantit Vacca.

Presidenti falënderoi Italinë që e drejton këtë bazë, duke koordinuar trupat e vendeve të ndryshme, të cilat tashmë kanë krijuar një bashkëpunim shumë të mirë mes tyre. Presidenti nënshkroi Librin e Vizitorëve të Nderit të bazës.

Vizita e Presidentit vijoi me një takim me trupat shqiptare që shërbejnë në bazë, të cilët i falënderoi për shërbimin që kryejnë ndaj atdheut dhe flamurit, si dhe u uroi një vit të ri me shëndet, begati e paqe për ta.

“Ju falënderoj për devotshmërinë, profesionalizmin dhe përgjegjësinë më të cilat kryeni detyrat tuaja. Sot gjendeni larg familjeve tuaja, por të jeni të sigurt se jeni gjithmonë në mendjet dhe zemrat tona”, - iu drejtua presidenti Begaj efektiveve ushtarakë.

Ndër të tjera, Presidenti shtoi: “Si përfaqësues të vendit tonë në misione paqeruajtëse, ju e lartësoni emrin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve kudo që ndodheni. Ju mishëroni vlerat tona më të mira. Falë punës suaj, vendi ynë konsiderohet partner i besueshëm në NATO”.

Në kontekstin aktual të sigurisë botërore, angazhimi juaj përbën një kontribut kritik, vijoi Presidenti.



“Shqipëria do të vijojë të kontribuojë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon e më gjerë si anëtare e NATO-s. Natyrisht, kjo kërkon rritje të buxhetit të Mbrojtjes dhe mbështetje për Forcat tona të Armatosura, kërkon mbështetje të familjeve për familjet tuaja dhe krijimin e kushteve, që ju të trajtoheni e të përgatiteni sa më mirë. Sot NATO nuk është vetëm një aleancë ushtarake, por edhe roje e vlerave të bashkësisë demokratike në botë, ndaj ne do të vijojmë angazhimin tonë maksimal në mbrojtje të vlerave të qytetërimin perëndimor, në të cilin bëjmë pjesë”, - tha ai.

Më tej, presidenti Begaj vizitoi ekspozitën e pajisjeve ushtarake të batalionit kinetik të bazës. Presidenti iu bashkua efektiveve të kësaj baze dhe drekoi bashkë me ushtarakët shqiptarë.



Anija "Butrinti P-134" dhe efektiv, pjesëmarrës në operacionin "Sea Guardian" në detin Egje, kthehen në atdhe

Anija "Butrinti P-134" dhe efektiv, pjesëmarrës në operacionin "Sea Guardian" në detin Egje, kthehen në atdhe. Kontingjenti II, gjatë qëndrimit në mision kreu disa operacione, duke identifikuar dhe shpëtuar një numër të lartë emigrantësh.

Gjatë kohës në mision u zhvilluan disa stërvitje ushtarake me anijet e vendeve aleate në ujërat ndërkombëtare.

Komandanti i Forcës Detare, kundër-admiral Adnand Agastra shprehu mirënjohje për përkushtimin e treguar gjatë kohës së qëndrimit në zonën e operacionit dhe përmbushjen me sukses të misionit. Të gjitha strukturat e Aleancës dhe vendet aleate kanë vlerësuar maksimalisht pjesëmarrjen, përkushtimin dhe profesionalizmin e personelit të Forcës Detare në këtë mision.

Roli i efektivëve dhe anijes shqiptare në këtë operacion është raportimi i trafikut të emigrantëve në zonën operacionale dhe ndërhyrja duke ofruar ndihmë në rastet kur konstatohet se jetët njerëzore janë në rrezik, si dhe detyrë shtesë nga NATO: monitorimi dhe identifikimi i anijeve ruse në rajon.



Anija "Trenton TEPF5" viziton portin e Durrësit

Anija e Forcave Detare të Shteteve të Bashkuara "Trenton TEPF5" mbërrin në Durrës për një vizitë të planifikuar në port.

Vizita e kësaj anijeje në vendin tonë nxjerr në pah fuqinë e partneritetit mes Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë në fushën e mbrojtjes.



In memoriam

Oficeri Guri Shyti, një nga nxënësit e parë të Shkollës së Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, ishte njeri i pajisur me intelekt e talent dhe si i tillë krijoi vepra të bazuara në talentin dhe arsimimin e tij.

Ai ishte dhe mbetet simbol i intelektualit të mençur, të urtë, krijues i talentuar në fushën e poezisë dhe prozës. Krijimtarinë e vet intelektuale e drejtoi në të mirën e njerëzve.

Guri Shyti ka lindur në vitin 1930, në fshatin Tragjas të Vlorës. Pesë klasat e shkollës fillore i kreu në fshatin e lindjes, pastaj bëri një klasë të shkollës tregtare të Vlorës në vitin shkollor 1941-1942. Pas luftës hyri në Shkollën Ushtarake “Skënderbej”. Që në bankat e shkollës së mesme provoi të shkruante ndonjë tregim, apo të përkthente ndonjë gjë nga gjuha ruse. Në vazhdim, u dërgua në ish-Bashkimi Sovjetik për studime ushtarake. Pas kthimit, mbaroi studimet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, për Kimi Industriale. Punoi në Ministrinë e Mbrojtjes, si oficer karriere, pastaj pedagog i kimisë ushtarake në Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Më vonë ishte pedagog i Armëve të Dëmtimit në Masë, në Akademinë Ushtarake, në Tiranë. Guri, përveçse pedagog në Akademinë Ushtarake, ishte pedagog edhe në Universitetin Shtetëror të Tiranës dhe në shkolla të tjera të larta, përkthyes i letërsisë artistike dhe autor i disa librave. Edhe kur doli në pension, Guri nuk e ndërpreu punën intelektuale deri në ditët e fundit të jetës. Gjatë kohës ka shkruar në organe të ndryshme të shtypit, ka botuar libra për specialitetin e tij ushtarak.

Pas daljes në pension ka shkruar librin autobiografik me përjetime “Sikur të isha vetëm...”. Ndërkohë, krijimtarinë e tij më të spikatur e gjejmë në librin “Një martesë e pazakontë”, botuar në vitin 2007 (Tregime, ese, vjersha). Gjejmë këtu krijimtari sa produktive edhe cilësore të një prozatori, poeti e publicisti të mirëfilltë, ku reflektohet bota e tij shpirtërore si dhe përgatitja profesionale e akademike. Nëse

Poeti dhe prozatori Guri Shyti, një nga nxënësit e parë të shkollës “Skënderbej”



tek proza e tij e shkurtër do të veçonim “Tregimet e Çimit” (mikut të rinisë me të cilin u ritakuan pas 50 vjetësh në një dasmë), apo “Lulet e pranverës”, mendimin e tij filozofik, Guri Shyti e evidenton më së miri në esenë me titull “Intelektuali i mirëfilltë”, ku që në krye të herës, referuar fjalorëve enciklopedik, shprehet se: “...intelektuali është njeri i pajisur me intelekt, që ka talent dhe krijon vepra të bazuara në talentin dhe arsimimin e tij. E thënë më shkoqur, intelektuali është një njeri i mençur, i urtë dhe krijues i talentuar në fushën e veprimtarisë së tij. Nga pikëpamja njerëzore, intelektuali i mirëfilltë është human, zemërgjerë, që di t’u bëjë lëshime atyre që mendojnë ndryshe nga ai, është njeriu që dialogun me kundërshtarët e tij në mendime e ka në bazën e veprimtarisë së tij, njeri që krijimtarinë e vet intelektuale e drejton në të mirën e njerëzve, pavarësisht nga përkatësia politike, kombi apo raca...”.

Pavarësisht këtyre referencave nga fjalori enciklopedik, në të vërtetë këto virtyte mishëronte në karakterin dhe intelektin e tij, intelektuali i mirëfilltë Guri Shyti. Po në këtë këndvështrim ishte edhe apeli i tij qytetar për gjuhën tonë.

Guri Shyti të mahnit me bukurinë e fjalës edhe në krijimtarinë e tij poetike, veçanërisht në vjershat me titull: “Atdheut”, “Mos më lëndo”, “Gruas në 50-vjetorin e martesës”, “Rrëfenjë për nipin”, “Pavdekësia” etj. Guri Shyti është marrë gjerësisht me përkthime. Ka përkthyer në shqip nga letërsia botërore, si nga gjuha ruse, edhe nga ajo italiane.

Ndër rreth tridhjetë librat e përkthyer e të botuar, ka klasikë si Tolstoi, Turgenievi, Hygoi, Cvajku, Abati Prevo, Luiza Mei, Elkot, Kiplingu, Norvudi, Sveva Casati Modignani, etj. Ka përkthyer mjaft vepra që kanë mbetur në dorëshkrim. U nda nga jeta në janarin e vitit 2020.


Skënderbegasi Dhimitër Lala, mjeshtrë i kinematografisë shqiptare

Ish-partizani e skënderbegasi Dhimitër Lala, i cili u ul në bankat e shkollës së kadetëve, më 28 mars 1945, ditën e çeljes së saj, është një nga emrat e njohur të kinematografisë shqiptare. Dhimitër Lala u lind në qytetin e Pogradecit, më 2 tetor 1931. Fëmijërinë e shkollimin e kaloi në këtë qytet të bukur buzë liqenit. Kur në fshat erdhi Brigada IV Sulmuese, ai i bashkohet asaj dhe del partizan. Me këtë njësi partizane ai ka marrë pjesë në shumë beteja, përfshi dhe atë për çlirimin e Tiranës. Ai është një nga kadetët e parë që erdhën direkt nga Lufta Antifashiste Nacional-Çlirimtare kadet në shkollën ushtarake “Skënderbej”, që ditën e parë të çeljes së saj, më 28 mars të vitit 1945.

Ai ka qenë ndër skënderbegasit më të mirë në mësimet atë kohë, por që shfaqte dhe pasionin e dëshirën e madhe për artin. Në kujtesën e tij, shkolla “Skënderbej” mbetet institucioni kryesor që e përgatiti, mësoi e edukoi që të ecte përpara në karrierën ushtarake dhe më pas në rrugën e vështirë të artit. Në vazhdim ai kreu dhe shkollën e lartë ushtarake, ku për disa vite punoi në strukturat ushtarake. Por në vitin 1953, ai largohet nga ushtria dhe nis punën në Kinostudion “Shqipëria e Re”. Artisti Dhimitër Lala ka bërë 25 filma dokumentarë e ka xhiruar shumë aktivitete brenda vendit dhe jashtë tij.

Ja si e kujton jetën e tij artisti Dhimitër Lala: “Në atë kohë u bë si modë që djem e vajza të vegjël iu bashkuan Lëvizjes Nacional-Çlirimtare. Kështu bëra edhe unë. Luftova deri në çlirimin e vendit. Për aftësi në luftë mora “Medaljen e Trimërisë”, “Medaljen e Çlirimit” dhe “Medaljen e Kujtimit”.

Pas lufte ndoqi shkollën “Skënderbej”, duke qenë një nga nxënësit e parë që erdhën nga lufta me armë mbi supë në shkollën ushtarake. Ndoqi më pas dhe studimet e larta ushtarake dhe u titullua oficer. Punoi pak vite në këtë zanat deri



në nëntor 1953 dhe pastaj kaloi tek Kinostudio “Shqipëria e Re”, fillimisht përgjegjës i kinemave dhe shumë shpejt ndihmës operator. Artin e donte shumë...

Si asistent operator punoi dhe në filmin e parë artistik shqiptar, filmin e Hysen Hakanit “Fëmijët e saj”. Në vitin 1958 kaloi përfundimisht te kronika e dokumentarët... I ra kryq e tërthor Shqipërisë e nuk la cep pa filmuar. Po kështu ka qenë prezent në shumë takime ndërkombëtare e ka filmuar dhjetëra personalitete të botës që vizituan Shqipërinë në vitet ‘50-’60 nga Hrushovi te Çu En Lai si dhe shumë udhëtime jashtë shtetit për të bërë

dokumentarë nga Kina në Irlandën e Veriut. ...Kur erdhi Hrushovi ishte i pari që pati kontakt me të.

Në prill 1975 e hoqën nga puna dhe nga partia, ndërsa më 12 tetor 1976 e arrestuan. Fillimisht bëri 7 muaj hetuesi dhe e dënuan 6 vjet për agjitacion e propagandë, vite, të cilat i kreu të plota. Situata ishte shumë e vështirë. Spaçi ka qenë kampi më i tmerrshëm, pasi të burgosurit punonin në minierë 8 orë. Ai s’kishte ndihmë nga familja pasi për 6 vjet nuk i shkoi njeri për ta parë...

Megjithëse e burgosën shpirtin e artistit nuk e ndrydhën dot. Disa prej artistëve të cilët punuan me të dhanë vlerësimet e tyre si:

Ylli Pepo, regjisor: “Dhimitër Lalën e kam njohur nga afër në vitin 1971, kur së bashku me tre kolegë të shquar erdhën në TVSH, i cili sapo hidhte hapat e parë drejt profesionalizmit. Ai ishte një profesionist. Më shumë se çdo fjalë flasin filmat që ruhen në arkiva e që përbëjnë një thesar të madh për breza të tërë”.

Elvira Diamanti, aktore: “Falë punës e kontributit të tij të çmuar, në Arkiv kemi pamje të rralla, të cilat kanë vlera të mëdha artistike, historike e dokumentare”.

Endri Keko: “Kam bashkëpunuar me të shumë herë dhe e çmoj për forcën dhe energjinë si askënd tjetër nga operatorët e kinokronikës, ndaj nuk hezitova ditët e para të shkurtit 1966 t’i propozoja të shkonim në një udhëtim të gjatë”.

Vladimir Marko: “Dhimitër Lala është një personalitet në artin e magjishëm të kinematografisë dhe padyshim një nga pionierët e parë. Ai ka qenë mësuesi im i parë drejt fotografisë, më ka mësuar kamerën dhe lojën brilante të imazhit e të dritës”.

Bujar Kapexhiu: “Kronikat e filmat dokumentarë janë skeduar në Arkivin Shtetëror si dëshmitarë të një pune të madhe e të palodhur të këtij kineasti të talentuar. Ai meriton të kujtohet, të vlerësohet dhe të falënderohet për kontributin e tij të shquar në kinematografi”.

Pirro Milkani: “Më shumë se kushdo tjetër për Lalën, flasin ato mijëra metra filma kronikalë e dokumentarë që realizoi dora e tij”.

Mevlan Shanaj: “Njohja e gjatë me të më ka ngulitur në mendje se ky njeri është shembulli i pasionit për punën dhe, nëse do të doja të portretizoja një kineast punëtor, nuk do të kërkoja model tjetër”.

Marrë nga kolana
“Skënderbegasit ndër vite...”



Lundrimi 59-vjeçar i flotiljes ushtarake

Nga fundi i vitit 1964, Këshilli i Mbrojtjes të asaj kohe vendosi ristrukturimin e FLD-së, e cila deri në atë kohë ishte e centralizuar, me vendbazim ishulli Sazan. Kështu u vendos që anijet mbiujëse luftarake të ndahen e të krijohen Flotilja e Durrësit dhe Flotilja e Vlorës. Si kriter bazë u caktimit të kuadrove do të merrej vendbanimi Durrës, dhe kjo për efekte strehimi.

Në përbërje të Flotiljes Durrës u caktuan anije minaheqëse, gjuajtëse kundër ND si dhe anije ndihmuese. Komandant ishte caktuar Dashamir Ohri. Ai vinte nga një përvojë e pasur si ish-komandanti i bazës së nëndetëseve të Pashalimanit, pikërisht në periudhën kur ishte krijuar konflikti i madh me aleatin e atëhershëm, Bashkimin Sovjetik. Ai është dhe një nga 17 oficerët e parë shqiptarë që ka mbaruar studimet në vitin 1947 në ish-Jugosllavi. Është, ndërkohë edhe një nga specialistët e parë të përgatitur në ish-Bashkimin Sovjetik dhe më pas, një ndër personat e parë, i përgatitur për nëndetëse po në ish-Bashkimin Sovjetik. Dashamir Ohri ka qenë pikërisht komandanti i nëndetëses së parë shqiptare, të ardhur me një katërshe nga Bashkimi Sovjetik.

Në mesditën e 4 janarit 1965, kap. i rangut III Dashamir Ohri, i emëruar komandant i Flotiljes Durrës, organizon një takim me kuadrot e Shtabit të Flotiljes dhe komandantët e anijeve, i njeh me planin e lundrimit të Flotiljes nga Sazani në Durrës. Rreth orës 20:00 fillon dalja e anijeve nga Sazani.

Dalja e anijeve u shoqërua me rënien e sirenavë si përshëndetje tradicionale e FLD-së. Lundrimi për në Durrës u bë natën, në formacion lundrimi dhe në kushtet e një deti të trazuar. Në mëngjesin e datës 05 janar 1965 anijet mbërritën në radën e Durrësit, e më pas u akostuan në Kalatën Lindore të Portit Detar Durrës.

Kështu data 5 janar 1965 shënon ditën e rikrijimit të Bazës Detare Durrës. Para komandës e Shtabit të Flotiljes dilnin detyra për konsolidimin e vendbazimit. Nisi gjithçka nga e para sepse mungonte infrastruktura, si bankinat, godina e komandës, kushtet e përgatitjes speciale, depot, baza materiale për përgatitjen e



NË PËRBËRJE TË FLOTILJES DURRËS U CAKTUAN ANIJE MINAHEQËSE, GJUAJTËSE KUNDËR ND SI DHE ANIJE NDIHMUESE. KOMANDANT ISHTE CAKTUAR DASHAMIR OHRI. AI VINTE NGA NJË PËRVOJË E PASUR SI ISH-KOMANDANTI I BAZËS SË NËNDETËSEVE TË PASHALIMANIT, PIKËRISHT NË PERIU DHËN KUR ISHTE KRIJUAR KONFLIKTI I MADH ME ALEATIN E ATËHERSHËM, BASHKIMIN SOVJETIK. AI ËSHTË DHE NJË NGA 17 OFICERËT E PARË SHQIPTARË QË KA MBARUAR STUDIMET NË VITIN 1947 NË ISH-JUGOSLLAVI. ËSHTË, NDËRKOHË EDHE NJË NGA SPECIALISTËT E PARË TË PËRGATITUR NË ISH-BASHKIMIN SOVJETIK DHE MË PAS, NJË NDER PERSONAT E PARË, I PËRGATITUR PËR NËNDETËSE PO NË ISH-BASHKIMIN SOVJETIK. DASHAMIR OHRI KA QENË PIKËRISHT KOMANDANTI I NËNDETËSES SË PARË SHQIPTARE, TË ARDHUR ME NJË KATËRSHE NGA BASHKIMI SOVJETIK.

efektivave etj.

Në sajë të punës vetëmohuese të kuadrove dhe efektivave u arrit që të ndërtohej bankina e silurë-hedhësve, ofiçina e silurëve si domosdoshmëri për anijet që pritej të vinin në vitin 1965 nga RP e Kinës. Ndihtesë të madhe për sigurimin e kushteve të vendbazimit dhanë edhe ndërmarrjet e qytetit të Durrësit si NN Porti, Porti Detar etj.

Rruga në të cilën ka ecur Baza Detare e Durrësit gjatë këtyre viteve është e mbushur me sakrificë në kryerjen e detyrave për mbrojtjen e ujërave tona territoriale nga veprimtaritë e paligjshme të anijeve të huaja, ndalimin e tentativave për kontrabandë etj.

Në vite, Bazës iu shtuan anije të tjera si silurë-hedhëse, gjuajtës detar, u ndërtuan vendbazimi në B. Pallë, ofiçina të riparimit të anijeve, godinat e komandës, shkolla e përgatitjes së efektivave etj.

Janë të shumtë ish-detarët që kanë kryer shërbimin ushtarak në Bazën e Durrësit që punojnë në profesione të ndryshme në Flotën Tregtare, në Flotën e Peshkimit etj. Në këtë 59-vjetor të rikrijimit të Bazës Detare të Durrësit, për punën plot përkushtim në shërbim të atdheut kujtojmë me nderim e respekt kuadrot e parë që hodhën themelet e krijimit dhe konsolidimit të Bazës, të cilët janë ndarë nga jeta, si komandantët e Bazës në vite: kap. rang III D. Ohri, kap. rang I M. Plani, shefi i Shtabit të Bazës, kap. rang III M. Lulolli, komandantët e skuadriljeve silurë-hedhëse, kap. rang III Selam Qejvani, kap. rang III Ali Canosinaj, komandantin e grupit të anijeve mbiujëse Petro Treni, Ing. mekanikët Piro Tushi, Ismet Beluli, Sami Shyti, Mark Berdufi, M. Hysi; kuadrot me përvojë Xh. Bujari, Vasil Petro, Spiro Kote, A. Sevrani, B. Demko, Mihallaq Papadhollu, B. Shehu, T. Gërveni, Skënder Sulku,



Halit Hima, Thoma Rubia, B. Këlmendi, S. Beluli, I. Rexha etj., si dhe Tasim Sinani, Hektor Meçe, A. Daja, D. Hoxha, që u larguan nga jeta shumë para kohe.

Përveç vështirësive që lindën nga ridislokimi, zgjerimi i forcave detare në përmasa të tilla, nuk mund të përballohej me efektivat që kishte, veçanërisht me kuadro. Edhe pse qeveria shqiptare i kishte paraprirë këtij zgjerimi, duke dërguar disa vite më parë studentë në akademitë e BS, ndër ta kishte grupe studentësh që ende nuk i kishin përfunduar studimet. Prandaj lindi nevoja e kalimit në forcat detare të shumë kuadrove nga repartet e artilerisë kundërajrore dhe bregdetare të ushtrisë. Ndërkohë, pranë shkollës së specialiteteve u ngrit një kurs 9-mujor me detarë që kishin mbaruar shkollën e mesme dhe që kishin aftësitë e duhura për t'i titulluar oficerë.

Pra, viti 1958 mund të quhet viti i një ndryshimi të madh në forcat detare shqiptare. Ato përfaqësoheshin në MMP nga kapiten i rangut I Abdi Mati dhe kishin këtë strukturë, Komanda dhe Shtabi i FLD-së – komandant – kapiten i rangut I Teme Sejko – shef i Degës Politike, kolonel Hajdar Aranitasi – komandant prapavije, kolonel Bedri Gjergji – shef Shtabi, kapiten i rangut II Mark Plani dhe anëtarë shtabi kapiten-lejtnant II Sezai Osmani, kapiten-lejtnant II Seit Jonuzaj, kapiten II Xhemali Milori, kapiten I Perlat Molla, kapiten-lejtnant II Qemal Hysaj, kapiten-lejtnant II inxhinier Tahir Hoxha etj.; Brigada e Nëndetëseve (Br. ND), me vendbazim në Pashaliman, Brigada e Mbrojtjes së Rajonit të Ujërave (Br. MRU), me vendbazim në Sazan, ku përfshiheshin: grupi i gjuajtësve detarë (GJD), me katër gjuajtës detarë; grupi i minaheqësive (MH), me dy minaheqëse të vogla, grupi i motosilurueseve (MS), me gjashtë motosiluruese tip 123-biz, detashmenti i anijeve ndihmëse (DAN) në varësi të komandës së prapavijës së Flotës në Vlorë, shkolla e specialiteteve (e transferuar nga Durrësi në Pashaliman), rajoni i pikave sinjalvrotuese (PSV) pranë komandës së Flotës në Vlorë, shërbimi hidrografik me qendër në Ujë të Ftohtë (tek “Shtatë Pallatet”). Pas dy vjetësh pune intensive nga komanda, shtabi, gjithë repartet e Flotës, xhenios së ushtrisë si dhe, falë mbështetjes së qeverisë, në mesin e vitit 1958, përfundoi ndërtimi i bazës së Pashalimanit, rikonstruksioni i bazës së Sazanit si dhe kompletimi

i reparteve të Flotës. Për të festuar rezultatet e arritura në zhvillimin e modernizimin e forcave detare si dhe për t'ia bërë ato të njohura popullit, u vendos që me rastin e përvjetorit të Ushtrisë Popullore të zhvillohej në gjirin e Vlorës një paradë detare.

Për punën e mirë në riorganizimin dhe kompletimin e forcave detare, shefi i seksionit të Marinës pranë MMP, Abdi Mati dhe komandanti i Flotës Teme Sejko u graduan kundëradmiralë, ndërsa shumë kuadro të tjerë u graduan jashtë radhe si dhe u bënë dekorime. Gjithashtu, për t'iu përgjigjur nivelit të zhvillimit të forcave detare shumë kuadro e detarë u dërguan për specializim në BS. Në vijim, efektivat e flotës intensifikuan stërvitjet në bazë dhe në det. Në verën e vitit 1959 edhe efektivat e katër nëndetëseve i kishin realizuar objektivat për marrjen në dorëzim të tyre, ndërkohë që nga anijet mbiujëse specialistët sovjetikë ishin larguar. Prandaj nga MMP u vu detyrë përgatitja dhe zhvillimi i një stërvitjeje me qëllim përpunimin e bashkëveprimit të llojeve të ndryshme të armëve të ushtrisë në bregdet, në kushtet e një zbarkimi të mundshëm armik nga deti. Për zhvillimin e saj u caktua si vend rajoni i gjirit të Drinit. Pasi u bënë të gjitha përgatitjet e nevojshme, në shkurt 1961 u vendos fillimi i stërvitjes së koduar “Drini-61”, ku, nën drejtimin e komandantit të FLD-së Hito Çako, morën pjesë: Brigada e nëndetëseve shqiptare dhe nëndetëset sovjetike të dislokuara në gjirin e Vlorës; Brigada e MRU (tetë minaheqëse, katër gjuajtës detarë, cisterna e naftës Patosi, anija silurë-kapëse dhe gjashtë motosiluruese) si dhe detashmenti i anijeve ndihmëse; Artileria Bregdetare Durrës-Rodon-Shëngjin; Repartet bregdetare të këmbësorisë të rajonit Durrës-Shëngjin dhe Aviacioni Ushtarak Shqiptar. Në stërvitje morën pjesë komanda dhe shtabi i FLD-së, përfaqësues nga Shtabi i Përgjithshëm e Ministria e Mbrojtjes, ndërsa nga pala sovjetike një grup këshilltarësh (si vëzhgues) nën drejtimin e kundëradmiralit Kulik, të gjithë të vendosur në Bazën Llundruese Tomori. Stërvitja zgjati 10 ditë dhe u zhvillua në kushtet e një moti të keq, mbi mesataren, por kjo gjë nuk ndikoi në realizimin e planit.

Nga fundi i vitit 1964 Këshilli i Mbrojtjes të asaj kohe vendosi ristrukturimin e FLD-së, e cila deri në atë kohë ishte e centralizuar, me vendbazim Ishulli Sazan. Kështu u vendos që anijet mbiujëse luftarake të ndahen e të krijohen Flotilja e Durrësit dhe Flotilja e Vlorës. Si rezultat i hapjes me botën,



PËR PUNËN E MIRË NË RIOORGANIZIMIN DHE KOMPLETIMIN E FORCAVE DETARE, SHEFI I SEKSIONIT TË MARINËS PRANË MMP, ABDI MATI DHE KOMANDANTI I FLOTËS TEME SEJKO U GRADUAN KUNDËRADMIRALË, NDËRSA SHUMË KUADRO TË TJERË U GRADUAN JASHTË RADHE SI DHE U BËNË DEKORIME. GJITHASHTU, PËR T'IU PËRGJIGJUR NIVELIT TË ZHVILLIMIT TË FORCAVE DETARE SHUMË KUADRO E DETARË U DËRGUAN PËR SPECIALIZIM NË BS. NË VIJIM, EFEKTIVAT E FLOTËS INTENSIFIKUAN STËRVITJET NË BAZË DHE NË DET. NË VERËN E VITIT 1959 EDHE EFEKTIVAT E KATËR NËNDETËSEVE I KISHIN REALIZUAR OBJEKTIVAT PËR MARRJEN NË DORËZIM TË TYRE, NDËRKOHË QË NGA ANIJET MBIUJËSE SPECIALISTËT SOVJETIKË ISHIN LARGUAR. PRANDAJ NGA MMP U VU DETYRË PËRGATITJA DHE ZHVILLIMI I NJË STËRVITJEJE ME QËLLIM PËRPUNIMIN E BASHKËVEPRIMIT TË LLOJEVE TË NDRYSHME TË ARMËVE TË USHTRISË NË BREGDET, NË KUSHTET E NJË ZBARKIMI TË MUNDSHËM ARMIK NGA DETI.

në ujërat tona u rrit intensiteti i lëvizjeve të anijeve të huaja për qëllime ekonomike, turistike e kontrabande. Për rrjedhojë u rrit edhe mundësia e shkeljeve të ujërave tona, u shtua veprimtaria për peshkim të paligjshëm, përpjekja për trafikë të klandestinëve, të drogës, të armëve etj.

Në të gjitha stërvitjet e përbashkëta, kuadrot tona kanë treguar përgatitje profesionale, kanë qenë në të njëjtin nivel me kuadrot e flotave të huaja partnere. Rol të rëndësishëm në zbatimin e detyrave kanë luajtur sistemi i vëzhgimit detar nëpërmjet PRT të vendosura në vendet e studiuara për këtë qëllim, të cilat janë pajisur me teknike bashkëkohore. Tashmë anijet me të cilat u rikrijua Baza Detare kanë dalë jashtë strukturës së Flotës dhe vendin e tyre e kanë zënë anije të reja të ardhura nga vendet aleate si SHBA, Holanda, Italia etj., të cilat i përgjigjen plotësisht kryerjes së detyrave të ruajtjes së ujërave tona territoriale.

Me ndryshimin e sistemit politik në vitin 1990, Baza detare e Durrësit pësoi ndryshimet e veta në konceptin e detyrave, organizim dhe strukturë.

Si rezultat i hapjes me botën, në ujërat tona u rrit intensiteti i lëvizjeve të anijeve të huaja për qëllime ekonomike, turistike e kontrabande. Për rrjedhojë u rrit edhe mundësia e shkeljeve të ujërave tona u shtua veprimtaria për peshkim të paligjshëm, përpjekja për trafikë të klandestinëve, të drogës, të armëve etj.

Baza Detare e Durrësit i ka përballuar të gjitha detyrat në ndalimin e këtyre veprimtarive të paligjshme. Në këtë aspekt kontribut ka dhënë edhe bashkëveprimi me anijet e Flotave Ushtarake të NATO-s. Vlen të përmenden veprimtaritë e përbashkëta të mjeteve të Bazës Detare të Durrësit, duke ndaluar misione kontrabande, anije naftëmbajtëse etj. Në të gjitha stërvitjet e përbashkëta, kuadrot tona kanë treguar përgatitje profesionale, kanë qenë në të njëjtin nivel me kuadrot e flotave të huaja partnere. Rol të rëndësishëm në zbatimin e detyrave kanë luajtur sistemi i vëzhgimit detar nëpërmjet PRT të vendosura në vendet e studiuara për këtë qëllim, të cilat janë pajisur me teknike bashkëkohore. Tashmë anijet me të cilat u rikrijua Baza Detare kanë dalë jashtë strukturës së Flotës dhe vendin e tyre e kanë zënë anije të reja të ardhura nga vendet aleate si SHBA, Holanda, Italia etj., të cilat i përgjigjen plotësisht kryerjes së detyrave të ruajtjes së ujërave tona territoriale.

Përshatja: MIMOZA GOLIKJA

NATO do të blejë 1000 raketa "Patriot", përmirësohet mbrojtja ajrore e aleatëve

Agjencia për Mbështetjen dhe Prokurimin e NATO-s do të mbështesë një koalicion aleatësh, përfshirë Gjermaninë, Holandën, Rumaninë dhe Spanjën për të blerë deri në 1000 raketa "Patriot" për të forcuar mbrojtjen e tyre ajrore, ndërsa vazhdon lufta e Rusisë kundër Ukrainës. Kontrata do të zgjerohet prodhimin evropian të raketave, duke rritur furnizimin dhe duke siguruar rimbushjen e rezervave aleate.

"Unë mirëpres njoftimin në kohë të aleatëve për të investuar në deri në 1000 raketa të reja të mbrojtjes ajrore Patriot për të forcuar sigurinë e Aleancës", - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. "Ky investim tregon forcën e bashkëpunimit të mbrojtjes transatlantike dhe përkushtimin e NATO-s për të mbajtur njerëzit tanë të sigurt. Sulmet me raketa dhe dronë rus ndaj civilëve, qyteteve dhe qytezave të Ukrainës tregojnë se sa e rëndësishme është mbrojtja ajrore moderne. Rritja e prodhimit të municioneve është çelësi për sigurinë e Ukrainës dhe për tonën", - tha ai.

Kontrata prej 5.5 miliardë dollarësh i është dhënë COMLOG, një sipërmarrje e përbashkët midis kompanisë amerikane "Raytheon" dhe kompanisë gjermane MBDA, me vendndodhje në Schrobenhausen, Gjermani. Vëllimi i madh i porosisë do të mbështesë ngritjen e një fabrike prodhimi për raketat "Patriot" në Gjermani. Sistemet e mbrojtjes ajrore "Patriot" mund të përdoren për t'u mbrojtur kundër avionëve, helikopterëve dhe raketave, duke i kapur ato në distanca të mëdha. Në vazhdim të luftës së Rusisë kundër Ukrainës, NATO ka vendosur bateritë e raketave "Patriot" për të mbrojtur aleatët në krahun e saj lindor. Aleatët e NATO-s kanë dorëzuar gjithashtu sistemet "Patriot" në Ukrainë dhe janë të përkushtuar për të forcuar më tej mbrojtjen e Ukrainës.

Agjencia e NATO-s për Mbështetjen dhe Prokurimin (NSPA) nga ana e saj është ofruesi kryesor i shërbimeve të NATO-s, duke ofruar një spektër të gjerë aftësish të integruara për Aleancën, vendet anëtare dhe partnerët e saj. Agjencia bashkon mbështetjen logjistike dhe aktivitetet e prokurimit të NATO-s, duke ofruar zgjidhje efektive dhe me kosto efektive të mbështetjes shumëkombëshe. NSPA është një agjenci e financuar nga klientët, që operon mbi bazën "pa fitim - pa humbje".

NSPA siguron blerje dhe mbështetje logjistike për NATO-n, aleatët e saj, partnerët dhe organizatat e tjera ndërkombëtare. Agjencia fokusohet kryesisht në mbështetjen për operacionet dhe stërvitjet e NATO-s; menaxhimin e ciklit jetësor të sistemeve të armëve; dhe menaxhimin dhe koordinimin e Sistemit të Gazsjellësit të Evropës Qendrore.

Mbrojtja ajrore dhe raketore e integruar e NATO-s

Mbrojtja e Integruar Ajrore dhe Raketore e NATO-s (NATO IAMD) është një mision thelbësor dhe i vazhdueshëm në kohë paqeje, krize dhe konflikti, duke siguruar dhe mbrojtur territorin, popullsinë dhe forcat e Aleancës kundër çdo kërcënimi ose sulmi ajror ose raketor. Ajo është një element jetik i parandalimit dhe mbrojtjes së NATO-s, e cila kontribuon në sigurinë e pandashme dhe lirinë e veprimit të Aleancës, përfshirë aftësinë e NATO-s për të përfunduar dislokimet e saj dhe për të ofruar një përgjigje strategjike.

Nga ana tjetër Mbrojtja e Integruar Ajrore dhe Raketore e NATO-s ofron një aftësi shumë të përgjegjshme, të fuqishme, kritike në kohë dhe të vazhdueshme për të arritur një nivel të dëshiruar të kontrollit të ajrit, ku Aleanca është në gjendje të kryejë gamën e plotë të misioneve të saj në kohë paqeje, krize dhe konflikti. IAMD e NATO-s është veçanërisht thelbësore në mjedisin aktual strategjik, i cili karakterizohet nga një përhapje e konsiderueshme e llojeve të ndryshme të aftësive ajrore dhe raketore dhe përdorimi i tyre agresiv nga kundërshtarët e mundshëm. Ajo përfshin të gjitha masat e nevojshme për të penguar çdo kërcënim ajror dhe raketor, ose për të anuluar ose ulur efektivitetin e tyre. IAMD e NATO-s kryhet duke përdorur një qasje 360 gradë, të përshtatur për të adresuar kërcënimet që burojnë nga të gjitha drejtimet strategjike.

Gjatë viteve të fundit, NATO ka rritur ndjeshëm gatishmërinë dhe reagimin e forcave të saj IAMD, duke siguruar që aftësitë e duhura të jenë në vendin e duhur në kohën e duhur. Përshatja e IAMD e NATO-s kryhet në përputhje me përshtatjen e përgjithshme të qëndrimit parandalues dhe mbrojtës të Aleancës, i cili mbetet mbrojtës dhe proporcional.

Gjithashtu përshatja IAMD e NATO-s merr parasysh të gjitha kërcënimet ajrore dhe raketore, duke përfshirë ato që vijnë nga një grup në rritje dhe në zhvillim e kapaciteteve të Rusisë, si dhe kërcënimet gjithnjë e më sfiduese ajrore dhe raketore nga aktorë të tjerë shtetërorë dhe jo shtetërorë, duke filluar nga mjetet ajrore pa pilot, (UAV) me aftësi të sofistikuar raketore, si raketat hipersonike.

Pas pushtimit të plotë të Rusisë në Ukrainë në vitin 2022, aleatët kanë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të forcuar IAMD të NATO-s. Këto masa janë një demonstrim i fortë i solidaritetit dhe vendosmërisë së aleatëve. NATO IAMD zbatohet përmes Sistemit të Integruar të Mbrojtjes Ajrore dhe Raketore të NATO-s (NATINAMDS), një rrjet i sistemeve të ndërlidhura kombëtare dhe të NATO-s, i përbërë nga sensorë, mjete komandimi dhe kontrolli, dhe sisteme armësh.

NATINAMDS është nën autoritetin e Komandantit Suprem të Aleatëve të NATO-s në Evropë.

Aktivitetet IAMD të NATO-s

Aktivitetet IAMD të NATO-s, ndryshojnë në varësi të rrethanave specifike të çdo situatë konkrete dhe mund të përfshijnë policimin ajror; mbrojtjen ajrore; mbrojtjen nga raketat balistike; mbrojtjen nga raketat e lundrimit; kundër raketave, mortajave dhe artilerisë, ose kundër sistemeve të avionëve pa pilot.



Sistemi i Integruar i Mbrojtjes Ajrore dhe Raketore i NATO-s (NATINAMDS), një rrjet i sistemeve të ndërlidhura kombëtare dhe të NATO-s, i përbërë nga sensorë, mjete komandimi dhe kontrolli dhe sisteme armësh, është krijuar për të mbrojtur forcat, popullsinë dhe territorin e NATO-s nga kërcënimet që vijnë nga të gjitha drejtimet strategjike. Është një sistem shumë i përgjegjshëm, i cili është i përgatitur të përdorë të gjitha masat e nevojshme për të penguar çdo kërcënim ajror dhe raketor, ose për të anuluar ose ulur efektivitetin e tyre, në kohë krize ose konflikti.

Në kohë paqeje, ka dy aktivitetet të mëdha në vazhdim brenda kornizës së IAMD të NATO-s, si Policia Ajrore e NATO-s dhe Mbrojtja Raketore Balistike e NATO-s (BMD).

Policimi Ajror i NATO-s është një misionet e përhershme në kohë paqeje që kryhet në kuadër të IAMD të NATO-s. Policimi Ajror i NATO-s është një demonstrim i fortë i solidaritetit midis aleatëve, pasi vendet me aftësi avionësh luftarakë ndihmojnë për të siguruar integritetin e hapësirës ajrore të atyre vendeve që nuk i zotërojnë ato. Rritja e Policisë Ajrore të NATO-s përgjatë krahut lindor të NATO-s në përgjigje të luftës në Ukrainë vazhdon të demonstrojë solidaritetin e aleatëve, si dhe rëndësinë e këtij misioni për parandalimin dhe sigurinë e aleatëve të NATO-s.

Misioni i Mbrojtjes së Raketave Balistike të NATO-s (BMD) është të mbrojtë popullsinë, territorin dhe forcat në Evropën e NATO-s kundër kërcënimit në rritje që vjen nga përhapja e raketave balistike nga jashtë zonës euro-atlantike, veçanërisht në juglindje të kufijve të Aleancës.

Në kohë krize, IAMD e NATO-s kontribuon në parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s duke demonstruar aftësinë, vendosmërinë dhe gatishmërinë e Aleancës për të kundërshtuar aktivitetet armiqësore, duke ruajtur kështu lirinë e veprimit të NATO-s në çdo kohë. IAMD e NATO-s është një pjesë integrale e sistemit të reagimit ndaj krizave të NATO-s. Masat e marra nga aleatët për të përmirësuar IAMD të NATO-s në përgjigje të pushtimit të plotë të Rusisë në Ukrainë janë demonstrime të forta të solidaritetit dhe vendosmërisë aleate.

Integrimi, nga ana tjetër, është një kërkesë thelbësore për IAMD të NATO-s, pasi siguron koordinimin dhe sinkronizimin e të gjitha aftësive të disponueshme të mbrojtjes ajrore dhe raketore. Një parakusht kryesor për integrim është ndërveprueshmëria (procedurale, teknike dhe njerëzore). Trajnimi dhe ushtrimet luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Ato gjithashtu demonstron vendosmërinë e aleatëve dhe mund të kenë një efekt parandalues.

Një shembull kyç i integritetit janë sistemet e Komandës dhe Kontrollit Ajror të NATO-s (Air C2), të cilat i ofrojnë Aleancës një aftësi për të menaxhuar operacionet ajrore të NATO-s (përfshirë policimin ajror) brenda dhe jashtë zonës Euro-Atlantike. Sistemet mbulojnë një teatër operacionesh prej 81 milionë kilometrash katrorë (pa përfshirë aftësinë e dislokueshme) nga pika më veriore e Norvegjisë deri në Detin Mesdhe dhe nga pika më lindore e Turqisë në Atlantikun e Veriut. Sistemet e NATO-s "Air C2", duke përfshirë programin e Sistemit të Komandës dhe Kontrollit Ajror të NATO-s (ACCS), i cili u krijua në 1999 për t'i siguruar Aleancës një sistem të vetëm, të integruar "Air C2", po zhvillohen vazhdimisht për të siguruar që Aleanca të jetë në gjendje të përballojë çdo sfidë ose kërcënim.

Komitetet përkatëse të NATO-s

Komiteti i Integruar i Politikës së Mbrojtjes Ajrore dhe Raketore (IAMD PC) është komiteti i lartë përgjegjës për të gjitha aspektet politike dhe politiko-ushtarake të IAMD të NATO-s, duke përfshirë misionet e policisë ajrore dhe BMD, si dhe elementët përkatës të Fuqisë së Përbashkët Ajrore. Ai i raporton Këshillit të Atlantikut të Veriut, organi kryesor vendimmarrës politik i Aleancës.

Dhe Grupi i Punës i Komitetit Ushtarak për Mbrojtjen Ajrore dhe Raketore është përgjegjës për shqyrtimin, këshillimin dhe dhënien e rekomandimeve mbi aspektet ushtarake të çështjeve të mbrojtjes ajrore dhe raketore për Komitetin Ushtarak të NATO-s, autoritetin e lartë ushtarak në NATO.

Një tjetër komitet që raporton në NAC, i angazhuar në fushën IAMD, është Konferenca e Drejtorëve Kombëtarë të Armatimeve (CNAD), e cila promovon bashkëpunimin midis vendeve në fushën e armatimeve dhe mbikëqyr zbatimin e Programit BMD të NATO-s.

Si ka evoluar IAMD e NATO-s

Historikisht, IAMD e NATO-s është një evolucion i konceptit të Mbrojtjes Ajrore të Integruar të NATO-s. Koncepti origjinal u zbatua në vitin 1961 nëpërmjet përdorimit të Sistemit të Integruar të Mbrojtjes Ajrore të NATO-s (NATINADS) nën komandën dhe kontrollin e Komandantit Suprem të Aleatëve në Evropë (SACEUR).

Gjatë Luftës së Ftohtë, NATINADS ishte një sistem kryesisht statik i vendosur kundër një kërcënimi të njëanshëm dhe të mirë përcaktuar të avionëve të drejtuar. Që atëherë, NATINADS ka evoluar në Sistemin e Integruar të Mbrojtjes Ajrore dhe Raketore të NATO-s (NATINAMDS), i cili përmbush sfidat e mjedisit më pak të parashikueshëm të sotëm dhe i cili mund të vendoset dhe trajtojë gamën e plotë të kërcënimeve ajrore dhe raketore.

Programi i Sistemit të Komandës dhe Kontrollit Ajror të NATO-s (ACCS) u krijua zyrtarisht në nëntor 1999, për t'i siguruar Aleancës një sistem të vetëm komandimi dhe kontrolli ajror të integruar për të menaxhuar operacionet ajrore të NATO-s brenda dhe jashtë zonës Euro-Atlantike. Që atëherë, sistemet e NATO-s "Air C2" kanë vazhduar të evoluojnë, duke siguruar që Aleanca të jetë në gjendje të përballojë çdo sfidë apo kërcënim.

Shkalla e paprecedentë e sulmeve raketore të Rusisë gjatë luftës së saj të paligjshme të agresionit kundër Ukrainës tregon rëndësinë e IAMD të besueshme dhe të fuqishme. Në Samitin e NATO-s 2022 në Madrid, aleatët konfirmuan se do të vazhdojnë të forcojnë IAMD të NATO-s për të siguruar që ajo të mbetet fleksibël dhe adaptive, si dhe koherente me masat e tjera parandaluese dhe mbrojtëse.

Aleatët mbeten të përkushtuar për forcimin e mëtejshëm të aftësive IAMD të NATO-s, duke përfshirë sigurimin e sensorëve, interceptorëve dhe komandës dhe kontrollit të nevojshëm, veçanërisht përmes Procesit të Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s (NDPP). Si rezultat, një numër aleatësh po blejnë sisteme të reja të mbrojtjes ajrore dhe raketore, duke përfshirë sisteme me bazë tokësore dhe detare. Këto asete të reja do të përmirësojnë më tej IAMD-të e NATO-s. Aleatët gjithashtu do të vazhdojnë të trajnojnë dhe ushtrorin forcat IAMD, duke përfshirë më shumë aspekte të IAMD-ve në stërvitjet dhe trajnimet e Aleancës.

“Unë, gruaja e brishtë dhe e pafuqishme, por me zemrën dhe karakterin e një mbreti, e, për më tepër, të një mbreti anglez”

Në traditën popullore, mbretërimi i Elizabetës I shihet si epoka e artë në historinë e Anglisë. Në një masë të madhe ky përcaktim mbështetet në lulëzimin e kulturës dhe fillimet e një perandorie detare që ndodhën gjatë mbretërimit të saj. Përveç të tjerash, mbretëresha ndihmoi në ngritjen e mitit të vet, duke sfiduar perandorinë e fuqishme spanjolle dhe sidomos, me fjalimin e zjarrtë që ajo mendohet të ketë mbajtur kur vendi kërcënohej nga pushtimi spanjoll.

Në vitin 1588, armiqësia anglo-spanjolle kishte arritur kulmin. Mbretërimi tridhjetëvjeçar i Elizabetës kishte Çimentuar shkëputjen e Henrikut VIII nga Roma, ndërkohë që Kisha e Anglisë po bënte të vetat përherë e më tepër praktikatat protestante. Në vitin 1570, papa Piu V e shkishëroi Elizabetën, një veprim ky që teknikisht e delegjitimonte atë si mbretëreshë në sytë e katolikëve. Ekzistonte një frikë e madhe nga planet e katolikëve, që të mbështetur prej Spanjës, mund të përpiqeshin të rrëzonin Elizabetën dhe në vitet 1580 kemi zbulimin e disa kompleteve, qofshin këto të vërtetë a të imagjinuar. Në vitin 1583, ambasadori spanjoll u largua për fare nga Anglia.

Veçanërisht i bezdisshëm për Spanjën ishte fakti që regjimi i Elizabetës, pasi u kishte dhënë përkrahje ekonomike, po mbështeste haptazi dhe ushtarakisht.

Mbretëresha Elizabetë I

Lindur më 7 shtator 1533, në Greenwich, Angli, vajza e Henrikut VIII dhe gruas së tij të dytë, Ana Bolejn, hipi në fron më 1588 pas mbretërimit të gjysmë-vëllait të saj më të vogël protestant, Eduardi VI (1549-53) dhe gjysmë-motrës së saj më të madhe katolike Mery I (1553-58). Gjatë mbretërimit të Elizabetës pati një fuqizim të Kishës së Anglisë, kufizime në rritje ndaj katolikëve dhe ndihmën për rebelët holandezë e për hygenotët francezë. Lindja e teatrove profesioniste solli lindjen e Shekspirit, ndërkohë që detarët aventurierë themeluan koloninë amerikane të Virxhinias, emërtuar sipas Mbretëreshës Virgjëreshë.

Më 1587, ndonëse me gjysmë zemër, ajo autorizoi ekzekutimin e të afërmes së saj, Mbretëreshës Mery të Skocisë, të akuzuar për bashkëfajësi në komplot, dhe në vitin 1588, ajo mbajti një fjalim të zjarrtë përpara trupave që mbronin Anglinë nga Armata Spanjolle. Meqë nuk qe martuar kurrë dhe nuk pati fëmijë, ajo ishte monarkja i fundit Tudor; pas saj froni i kaloi të birit protestant të Mbretëreshës Meri të Skocisë, Xhejms. Vdiq më 24 mars 1603, në Pallatin Richmond, Angli.

Në Karaibe dhe në Atlantik anijet pirate angleze, piratët e mbështetur nga qeveria, plaçkitnin karvanët e anijeve që transportonin thesaret nga kolonitë spanjolle dhe i dërgonin ato në Angli. Në vitin 1587, një flotë e komanduar nga Sër Fransis Drejk u bë e famshme se i dogji mjekrën mbretit të Spanjës, kur shkatërroi më shumë se 24 anije të Filipit II, mu brenda në portin e Kadizit. Për Filipin kjo qe pika që e mbushi kupën. Në fillim të vitit 1588 autoritetet britanike mësuuan se ai po përgatiste një armatë tepër të madhe me anije për të pushtuar Anglinë.

Anglia ishte bërë veçanërisht e cenueshme në politikën e saj kontinentale edhe prej faktit që në luftërat e gjata fetare në Francë, pala katolike ndërkohë kishte fituar epërsi. Aty nga fundi i majit, më se 130 anije spanjolle me 18.000 burra, të komanduara nga Duka i Medina Sidonës, u nisën nga Spanja për t’iu bashkuar forcave tokësore nën komandën e Dukës së Parmës, në afërsi të Kalesë. Më 28 e 29 korrik, komandanti anglez, Lordi Howard i Effngham-it, urdhëroi luftanijet angleze të sulmonin flotën spanjolle pranë brigjeve franceze, në atë që u quajt: Beteja e Gravelines.

Një pjesë e madhe e armatës spanjolle u shpërnda në Detin e Veriut, duke i ardhur më në



fund rrotull Skocisë, ku ndeshi në një stuhi, gjatë së cilës pjesa më e madhe e anijeve u mbytën në afërsi të brigjeve të Irlandës. Fare pak anije dhe njerëz arritën të shpëtonin e të ktheheshin në Spanjë. Paqja me Spanjën u vendos vetëm pas disa vitesh, por pas kësaj humbjeje Spanja s’do përbente kurrë më kërcënim për Anglinë.

